

VENDIM
Nr.368, datë 11.6.2004

**PËR NJË NDRYSHIM E SHITESË NË VENDIMIN NR.241, DATË 18.5.2000 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR RIORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË
ÇMIMEVE TË BARNAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 e 45 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.241, datë 18.5.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim e kjo shtesë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Riorganizimin e Komisionit të Çmimeve të Barnave pranë Ministrisë së Shëndetësisë, i cili të përbëhet nga kryetari dhe 8 anëtarë përfaqësues nga:

- Ministria e Shëndetësisë	kryetari dhe 2 anëtarë;
- Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor	2 anëtarë;
- Ministria e Financave	1 anëtar;
- Shoqata e Grosistëve Farmaceutikë	1 anëtar;
- Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë	1 anëtar;
- Shoqata e Konsumatorëve të Shqipërisë	1 anëtar.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. ISKSH-ja mbledh dhe përpunon çmimet e barnave që rimbursohen, të cilat ia paraqet Komisionit të Çmimeve të Barnave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano